

VENDIM
Nr. 363, datë 30.6.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 570, DATË 3.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE AKSIONARE SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 8 e 18, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të kreut III, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 570, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull dhe kudo në përmbajtje, fjalët “... shoqëri aksionare shtetërore ...” zëvendësohen me “... shoqëri tregtare shtetërore ...”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës emërohen nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë tregtare, sipas një procedure transparente dhe të bazuar në parimin e meritokracisë. Asambleja përcakton me vendim vendet vakante për anëtar të këshillit mbikëqyrës, publikimin e tyre në faqen zyrtare të institucionit dhe strukturën përgjegjëse për mbledhjen e kërkesave të paraqitura.

Asambleja e Përgjithshme ngre komisionin e vlerësimit të kërkesave, i cili shqyrton kërkesat e paraqitura, vlerëson plotësimin e kriterëve dhe skualifikon kandidatët që nuk i plotësojnë ato, si dhe përgatit listën me emrat e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, dhe ia propozon për shqyrtim Asamblesë.

Në shoqëritë tregtare shtetërore të krijuara sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ose në shoqëritë me kapital të përbashkët, ku shteti zotëron kuota ose aksione, përzgjedhja e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të palës shtetërore do të bëhet në përputhje me parashikimet në aktet e themelimit apo statutin e këtyre shoqërive.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. I njëjti person nuk mund të marrë pjesë në më shumë se 2 (dy) këshilla mbikëqyrës, me përjashtim të rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.”.

4. Në pikën 4, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Ekspertë të pavarur, të cilët nuk kanë lidhje varësie apo interesi me shoqërinë përkatëse.”.

5. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Funksionarëve politikë të liruar nga detyra nuk u lejohej të emërohen apo të riemërohen si anëtarë të këshillit mbikëqyrës në shoqëri tregtare shtetërore, për një periudhë prej 2 (dy) vjetësh, duke filluar nga data e lirimit nga detyra.”.

II. Mandatet e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, të emëruar përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk ndërpriten. Këta persona ushtrojnë funksionin e anëtarit të këshillit mbikëqyrës deri në përfundimin e mandatit, sipas afatit të parashikuar në përputhje me aktin e emërimit të tyre.

III. Ngarkohen të gjitha institucionet që kanë aksione/kuota në shoqëri tregtare shtetërore dhe shoqëritë tregtare shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku